

## FTESË PËR OFERTË

Shoqata e Paraplegjikëve dhe Paralizës së Fëmijëve të Kosovës – HANDIKOS, për nevoja të implementimit të aktiviteteve të ndryshme gjatë zbatimit të projekteve, është duke kërkuar ofertues për shërbime hotelerie në komunën e Ferizajt.

Të gjithë ofertuesit duhet të përfshijnë këto shërbime:

- Salla e trajnimeve e përshtatshme për deri 25 persona;
- Ofrimi i ujit për pjesëmarrës gjatë trajnimit;
- Ofrimi i kafesë për pjesëmarrës gjatë pauzave;
- Dreka për pjesëmarrës;

## KRITERET PËR APLIKIM

Të gjithë ofertuesit duhet të plotësojnë këto kriteret:

- Duhet të ndodhet në komunën e Ferizajt;
- Duhet të kenë qasje fizike për personat me aftësi të kufizuara;
- Duhet të kenë hapësirë të mjaftueshme në sallën e trajnimeve, që siguron akomodimin e deri 25 personave duke respektuar distancën fizike;
- Duhet të ketë ndriqim të mjaftueshëm dhe hapësirë të përshtatshme për përdorimin e projektorit;

## DOKUMENTET PËR DORËZIM DHE PËRMBAJTJA E OFERTËS:

- Çertifikata e regjistrimit të biznesit;
- Çmimet e shërbimeve në euro duke mos përfshirë TVSH-n (HANDIKOS është e liruar nga TVSH prandaj çmimet duhet të jenë pa TVSH);
- Ofera financiare e ndarë me cmime për: sallë, ujë, kafe dhe drekë;
- Oferta duhet të jetë e nënshkruar dhe vulosur/apo me llogo zyrtare;

Të gjithë të interesuarit, ftohen të dorëzojnë ofertat e tyre në email-in: [handikos@handi-kos.org](mailto:handikos@handi-kos.org), ose edhe në mënyrë fizike në zyrat e HANDIKOS, me adresë: Rr.Nekibe Kelmendi, Veternik, Prishtinë, më së largu deri më 21/01/2022.

Për çdo informatë shtesë, ndjehuni të lirë të na kontaktoni në Email-in. [Ilir.gashi@handi-kos.org](mailto:Ilir.gashi@handi-kos.org): Tel +383 49 377 655